REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Nr. 359/1 prot Klos, më 24.01.2024

**Lënda:** Shkresë përcjellëse.

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Klos**

**Klos**

***Të nderuar,***

Bashkëlidhur gjeni listën emërore për miratim nga ana juaj për Subvencionimin e Interesave të Kredive për individ familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti për vitin 2024.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI I BASHKISË**

**Valbona KOLA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KLOS

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KLOS**

Nr. _____ Prot. Klos, më___/01/2024

**PROJEKT – VENDIM**
**PËR**
**"MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE MASËN E SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDIVE PËR INDIVIDË/FAMILJE QË PËRFITOJNË BANESA ME KOSTO TË ULËT ME KREDI TË LEHTËSUAR NGA SHTETI, PËR VITIN 2024"**

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", përkatësisht në nenin 24, pikën 2 të tij, Ligjin 22/2018, "Për Strehimin Social", neni 15, pika 5, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384, datë 12.06.2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.453, datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionimeve të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti", shkresës nr. 741 prot., datën 12.01.2024, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Mbi fondet për programet e Strehimit për vitin 2024", procesverbalin përfundimtar të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Klos, nr.319 prot., datë 24.01.2024 ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë, me nr.14 datë 23.01.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Strehimit Social", i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projekt-vendimin si më poshtë vijon:

- Miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti, për vitin 2024, sipas listës bashkëngjitur.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Klos.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Valbona KOLA**

Konceptoi & printoi: L.Barmeta &L. Çeka
Pranoi: S.GJini
Verifikoi & konfirmoi: A.Laçi
Datë: 24.01.2024
Nr. Kopjeve: 3 (tre)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KLOS

*Adresa: Rruga "Jaho Hoxha", Ndërtesa nr.2, Hyrja nr.2, Klos-Shqipëri, e-mail: info@bashkiaklos.gov.al*

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA KLOS**
**SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL, NDIHMËS EKONOMIKE, STREHIMIT SOCIAL, BARAZISË GJINORE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Nr ______ prot                                                                 Klos, më ___.___.2024

**RELACION**

**PËR**

**"MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE MASËN E SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDIVE PËR INDIVIDË/FAMILJE QË PËRFITOJNË BANESA ME KOSTO TË ULËT ME KREDI TË LEHTËSUAR NGA SHTETI, PËR VITIN 2024"**

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", Bashkia Klos ka filluar zbatimin e disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë për strehim.

Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur aplikime të cilët plotësojnë kriteret për tu kualifikuar në fazën e dytë dhe pas plotësimit të dokumentacionit përkatës, dosjet janë paraqitur në Komisionin e Strehimit të Bashkisë për shqyrtim dhe vlerësim.

Në zbatim të pikës 18 të VKM nr.384 datë 12.06.2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", strukura përgjegjëse e strehimit në bashki e dërgon për miratim listën përfundimtare të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak që duhet ta marrë në shqyrtim në mbledhjen e parë të radhës. Pas miratimit në këshillin bashkiak, lista e përfituesve u dërgohet Entit Kombëtar të Banesave dhe institucioneve financiare që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e linjës për zbatimin e këtij programi.

Me datë 24/01/2024, u mbajt mbledhja e Komisionit të Strehimit, ngritur me urdhër të Kryetarit të bashkisë me nr.14 prot.,datë 23.01.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Strehimit Social", ku në fund u miratua lista përftituese dhe masa e subvencionimit të interesave të kredive, e cila u

dërgua pranë strukturës përgjegjëse për strehim në bashki, shoqëruar me procesverbalin përfundimtar të komisionit të Strehimit të Bashkisë Klos me nr.317 prot.,datë __.01.2024.

Në këto kushte për realizimin e këtij programi të strehimit social duhet të miratohet në këshillin bashkiak projekt-vendimi i propozuar "Për miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvensionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti, për vitin 2024", sipas listës së bashkëngjitur të miratuar nga Komisioni i Strehimit sipas formatit të listës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

***Sektori i Kujdesit Social, Ndihmës Ekonomike, Strehimit Social, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut***
***Znj.Sanije Gjini***

***Zv/Kryetari***
***Znj.Adelina Laçi***

## LIDHJA 3 – Formati i listës emërore (Aplikimet 2024)

| Nr. Rendor | Emri/Atësia/Mbiemri | Përbërja familjare | Struktura e apartamentit që përfiton | Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a) | Kushtet familjare (neni 16, germa (b) | Kushtet sociale (neni 16, germa (c) | Të ardhurat mujore neto të familjes | Punësimi | Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja | Numri i kontaktit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Orlando Bala | 3 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 60 356 | Shtet-Privat | 6.239.590 | 0682092094 |
| 2 | Mariglen Karaj | 2 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 108 205 | Shtet-Privat | 4.456.850 | 0698352296 |
| 3 | Shpetim Guna | 5 | 3+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | - | - | 57 406 | Shtet | 4.456.850 | 0694890833 |
| 4 | Gazmir Skeja | 5 | 3+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 43 400 | Privat | 5.348.220 | 0688434674 |
| 5 | Xhaferr Krosi | 2 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 107 680 | Shtet | 6.239.590 | 0684266252 |
| 6 | Etmond Demiri | 3 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 107 781 | Shtet | 7.576.645 | 0688772500 |
| 7 | Klodian Mirdita | 4 | 2+1 | Disponojnë banesë në pronësi | – | - | 111 400 | Shtet-Privat | 4.456.850 | 0685519146 |
| 8 | Dylejman Shabani | 3 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 89 709 | Shtet-Privat | 5.348.220 | 0695275301 |
| 9 | Fatjon Gjini | 3 | 1+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | – | 78 607 | Shtet-Privat | 4.456.850 | 0682143791 |
| 10 | Xhuljana Perjaku | 4 | 2+1 | Nuk disponojnë banesë në pronësi | – | - | 122 935 | Shtet-Privat | 5.348.220 | 0688645992 |

***Shënim:***

1- Lista emërore duhet të jetë e shtypur (jo e shkruar me shkrim dore);
2- Çdo faqe e listës emërore duhet të ketë vulën e Këshillit Bashkiak;
3- Shkresa përcjellëse me firmë të Kryetarit të Bashkisë, së bashku me listën emërore i dërgohet EKE
   më poshtë:
   - **Entit Kombëtar të Banesave**, Rruga e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5 (ish shtëp
   - **Banka Kombëtare Tregtare,** Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë
   - **Intesa SanPaolo Bank,** Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë
   - **Raiffeisen Bank,** Rruga e Kavajës, Pallati 71, Shk.1, Ap.4, Tiranë.
4- Shkresa përcjellëse, duhet të përmbajë numrin total të listës së familjeve që i dërgohen bankës.
   dërgohet edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por pa i bashkëlidhur listën emërore;
5- Në kolonën 2, vihet emri i kryefamiljarit/personit që aplikon;
6- Në kolonën 3, përbërja e familjes sipas çertifikatës së gjendjes familjare;
7- Në kolonën 4, struktura e apartamentit që përfiton sipas normave të strehimit në fuqi;
8- Në kolonat 5, 6 e 7 vendoset një nga rastet e parashikuara në nenin 16, germat (a), (b) e (c) të ligjit nr
9- Në kolonën 8, vendosen të ardhurat mujore neto të familjes;
10- Në kolonën 9, vendoset statusi i punësimit të kryefamiljarit/aplikantit:
    a. e/i punësuar në shtet;
    b. e/i punësuar në privat;
    c. i vetëpunësuar (biznes i vogël me xhiro vjetore jo më të madhe se 8,000,000 lekë).
11- Në kolonën 10, vendoset kufiri maksimal i kredisë që përfiton familjes sipas lidhjes 2;
12- Në kolonën 11, vendoset numri i kontaktit i kryefamiljarit/personit që po aplikon.+1